



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 13:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar" (*Komision për dhënie mendimi*)
2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Lefter Koka, Zef Shtjefni, Halit Valteri, Klajdi Qama dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Tatiana Nurçe, Ilir Beqaj dhe Kujtim Gjuzi.

Të ftuar:

Besmir Beja – Drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Irena Malolli – Drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Gentjan Sala – kryetar i AMA-s

Jetmir Braha – Drejtor i Autorizimeve në AKEP

Bleron Dokle – përfaqësues nga AKEP

Niko Peleshi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot kemi për shqyrtim projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

Të ftuar kemi kryetarin e Autoritetit të Medieve Audiovizive, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Infrastrukturës dhe nga AKEP-i.

Pas këtij projektligji do të shqyrtojmë dhe projektligjin e komunikimeve elektronike, i cili është edhe ligji që na intereson më shumë, sepse është në fushës tonë të përgjegjësisë. Për shkak se ky ligj lidhet me ndryshimin e ligjit të komunikimeve elektronike, ne jemi përfshirë për dhënie mendimi. Pra, meqenëse jemi një komision periferik për këtë çështje, dua t'ju sugjeroj që të ndalemi në ato nene që lidhen me ligjin e komunikimeve elektronike, konkretisht me AKEP-in, meqenëse janë në fushën tonë, gjithsesi është në të drejtën tuaj ta çmoni.

Këtë projektligj e kemi kaluar në parim dhe sot kemi diskutime dhe votimin nën për nen. Ky projektligj ka ardhur me variantin e Këshillit të Ministrave, por nga grupi i punës janë bërë plotësime dhe ripunime në konsultim me OSBE-në dhe organizata të tjera. Janë bërë shumë dëgjesa, por më intensive janë zhvilluar këto ditë, siç i keni ndjekur, të cilat kanë shërbyer në përmirësimin e këtij drafti. Nga grupi i punës dhe nga Komisioni i Medias kemi marrë një draft të përmirësuar, të cilin e kemi përpara në formën e një table dhe do ta konsiderojmë në diskutimin dhe miratimin nën për nen.

Fjalën do t'ia kaloj relatorit, zotit Pëllumbi, për të bërë një prezantim dhe propozim për mënyrën sesi duhet të vazhdojmë më tej.

Fjala për zotin Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e thatë edhe ju, ky është një projektligj, të cilin ne e kemi votuar në parim, pra i kemi bërë edhe diskutimet për këtë projektligj dhe duhet ta kalojmë në votimin nën për nen. Meqenëse ky ligj ka një sensibilitet të lartë, situata është e tillë: varianti i Këshillit të Ministrave nga varianti që kemi përpara ka pësuar ndryshime të mëdha, duke marrë parasysh jo vetëm sugjerimet e aktorëve dhe faktorëve të interesuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe sugjerimet e OSBE-së, e cila ka sugjeruar ndryshime dhe ndërhyrje të drejtpërdrejta në çdo nen.

Kur ne kalojmë ligje, kemi aktorë të cilët janë të kënaqur, por edhe të pakënaqur, sepse konturimi në vetvete nuk i pëlqen askujt.

Dua ta theksoj edhe një herë që ky është një projektligji që zbatohet për transmetimet elektronike dhe është gati i njëjtë me ligjin për transmetuesit audio apo audiovizive. Pra nuk është se këtë media po e veçojmë nga pjesa tjetër e medieve, por po e vendosim në një kuadër të barabartë me të gjitha mediet përpara ligjit dhe detyrimeve.

Të nderuar kolegë, sikurse e tha edhe kryetari, ne nuk jemi profesionistë të kësaj fushe, ne jemi deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe mund të japim sugjerimet tona, por fusha jonë e veprimtarisë është larg të qenurit ndikues në mënyrë të drejtpërdrejtë në pikat dhe nenet që na janë vënë përpara, prandaj sugjeroj që të ndalemi më gjerësisht në ato nene që prekin veprimtarinë dhe aktivitetin e AKEP-it, i cili është edhe një ent rregullator që raporton përpara nesh dhe ne jemi përgjegjës. Duke pasur parasysh këtë, unë sugjeroj që të fillojmë me nenet sikurse është drafti i përmirësuar me mjaft ndryshime nga aktorët dhe faktorët e tjerë, por edhe nga OSBE-ODIHR-i dhe të ndalemi në mënyrë specifike në ato ndryshime që i bëhen ligjit dhe që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë e AKEP-it. Kjo do të na ndihmonte dhe në projektligjin tjetër që kemi për AKEP-in, ku ne jemi komision përgjegjës dhe duhet të themi mendimin e fundit për ndryshimet që kemi.

Niko Peleshi – Për procedurë, fjalën e ka kërkuar zoti Baraj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Meqenëse ka një sensibilitet shumë të madh të opinionit publik në lidhje me këtë ligj, shpeshherë qëndrimet vijnë për shkak se vende-vende opinionit publik nuk është i informuar, qoftë edhe ky komision, në përmasat e duhura. A mund të bëni një përmbledhjeje shumë të shkurtër për të treguar se ku janë kontestimet dhe drafti i fundit sa i merr parasysh këto kontestime?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Bitri.

Robert Bitri – Në mbledhjen e kaluar u tha se janë pyetur edhe grupet e interesit, këto grupe a e kanë lexuar ligjin? Nëse e kanë lexuar, cilën pjesë të ligjit kontestojnë? Pra, cili është pretendimi i tyre për ligjin, për cilin nen apo për cilën pjesë?

Meqenëse shtypi flet në përgjithësi dhe jo konkretisht, pra organizatat e gazetarëve në botë, shoqatat e të tjerë, kjo e vendos opinionin publik në një dilemë nëse me të vërtetë po shkelen të drejtat e njerëzve apo këta njerëz duan azap pa kontroll. Pra, nëse ne do të kontestojmë institucionet shtetërore, siç është AMA apo AKEP-i, që janë marrë deri tani me medien, i bie që as firmat të mos merren me tatimorët dhe as ushqimi të kontrollohet nga AKU-ja, sepse nuk duan. Në këtë rast ne kemi një mjegull që duan të ngrenë grupet e interesit apo ka gjëra konkrete? Ata, duke lexuar ligjin, ndiejnë se do të futen në një kornizë

ligjore si të gjitha institucionet e tjera dhe nuk e duan këtë kontroll. I tërë shtypi ankoheq që del me humbje, por, kur dëgjojmë që shumë gazetarë janë milionerë, thua nga dalin këto shifra. Unë nuk e kuptoj përse u duket si një gjë abstrakte, kur institucionet kanë qenë, janë dhe do të jenë gjatë gjithë kohës nën kontroll të gjithë punës së çdo individi apo çdo institucioni siç është edhe media.

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Kërkesat që bëjnë zoti Baraj dhe zotit Bitri na rikthejnë në pjesën e diskutimit në parim. Megjithatë, duke qenë se ky është një projektligj që ka krijuar një sensibilitet në opinionin publik, unë mbështes personalisht kolegun që tha ka më shumë tymnajë se sa ka mbështetje në ndryshimet ligjore që bëhen. Unë them t’ua japim fjalën propozuesve të këtij projektligji për të na bërë një sintezë të shkurtë për çfarë dhe ku grupet e interesit apo mediet *online*, të cilat në këtë rast janë të vetmet që e kundërshtojnë në dijeninë time, nuk janë dakord me këtë gjë. Kjo më shumë për të na qartësuar edhe ne si deputetë të Kuvendit, se sa për të ndërhyrë në nene të cilat janë të koalituara nga mjaft aktor edhe faktorë që kanë punuar gjatë me këtë projektligj.

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kyretar!

Pak a shumë të njëjtën gjë dua edhe unë, meqenëse nuk do të kemi mundësi për ta para variantin integral që vjen nga Komisioni i Ligjeve, pra nëse mund të na prezantoni shkurtimisht përmirësimet që i janë bërë variantit që ka ardhur nga qeveria, ku konsistojnë ndryshimet në mënyrë të përmbledhur. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe kryesisht do të fokusohemi në çështjet e AKEP-it dhe komunikimeve elektronike, siç e tha edhe relatori, por përsëri duam një panoramë të ndryshimeve, ku konsistojnë, si e përmirësojnë projektligjin e sjellë nga qeveria dhe sa janë marrë në konsideratë mendimet dhe sugjerimet e grupeve të interesit.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Nëse nuk keni ndonjë kundërshtim, do të procedojmë sipas propozimeve të zonjës Gjermani dhe zotit Pëllumbi, pra të dëgjojmë të ftuarit për ndryshimet që u janë bërë neneve nga grupi i punës, nga Komisioni i Ligjeve, i cili sapo e ka miratuar, si janë reflektuar vërejtjet e OSBE-së dhe organizatave të tjera. Më pas vazhdojmë me shqyrtimin nën për nën dhe me votimin.

Besmir Beja – Faleminderit, zoti kryetar!

Është kënaqësi të jem përsëri përpara jush! Në vijim të interesit dhe të përgjigjeve të pyetjeve, ky është një nga draftet më të konsultuara që është paraqitur ndonjëherë për t’u

miratuar në Kuvend. Ka pasur një histori të gjerë konsultimi, si gjatë kohëzgjatjes së hartimit të saj nga qeveria dhe para miratimit nga Këshilli i Ministrave. Ju të gjithë jeni dëshmitarë të procesit konsultues të kryer nga disa komisione të Kuvendit për të përmirësuar sa më shumë që të jetë e mundur cilësinë e ligjbërjes, por nga ana tjetër edhe për të garantuar rregullimin e një fushe që deri më sot ishte e parregulluar.

Në këndvështrimin tim, nga të gjitha komentet që janë paraqitur deri më sot akoma nuk kam marrë komente që lidhen me përmbajtjen e neneve të caktuara. Pra, të gjitha organizatat e shoqërive civile dhe mediet e interesuara kanë paraqitur në parim kundërshtimin e tyre për mos rregullimin e një fushe të caktuar. Në qasjen time dhe të Këshillit të Ministrave kjo fushë duhet rregulluar, bazuar edhe në parimin e neutralitetit të rregullimit të medieve. Pra, një platformë e caktuar nuk mund të mos rregullohet kur e njëjta platformë që ushtron po të njëjtën funksion informimi ndaj publikut është rregulluar. Kjo do të thotë që mediet elektronike nuk mund të rrinë të parregulluara në kohën kur mediet e tjera që ofrojnë shërbim medietik ndaj publikut janë gjerësisht të rregulluara.

Ajo që është bërë nga Këshilli i Ministrave, si dhe me ndërhyrjet e fundit që janë bërë nga grupi i punës në Kuvend, është përmirësimi ose rregullimi me të njëjtën qasje i medieve elektronike, ashtu siç janë rregulluar edhe mediet e tjera tradicionale. Për këtë shkak, nga ndërhyrjet që janë bërë në ligjin për mediet audiovizive, është ndryshuar edhe titulli i këtij ligji duke e bërë “Për mediet në Republikën e Shqipërisë”.

Pra nuk ka ndonjë gjë të re, i njëjti rregullim që ne kemi kryer për mediet tradicionale është bërë edhe për mediet *online*. Kjo është një garanci për qytetarët shqiptarë. Duhet theksuar se nuk kemi rregulluar përmbajtjen e medias, pra nuk rregullojmë përmbajtjen e lajmit, por procedurën se si këto medie e ofrojnë shërbimin medietik për publikun. Në rast se ata cenojnë interesin e publikut, mund të krijojmë mekanizma që këto medie t’i përgjigjen informacioneve të pavërteta ose në raste të caktuara është, siç është i njohur aktualisht në ligjin për AMA-n, e drejta e përgjigjes, pra t’u përgjigjen qytetarëve për të vendosur të njëjtin informacion, nëse kanë informacione të pasakta ose të pavërteta. Pra kjo është vetëm procedurë se si funksionojnë këto platforma medietike, de fakto medie, të rregulluara në legjislacionin shqiptar.

Për t’iu përgjigjur më në detaje pyetjeve, ka pasur një proces shumë të gjatë konsultimi edhe me organizatat ndërkombëtare. Të vetmit që kanë dhënë komente nen për nen me qëllim përmirësimin e draftit kanë qenë: OSBE-ja, Këshilli i Europës dhe Komisioni i Bashkimit European. Gjerësisht është punuar me ekspertin e OSBE-së, i cili në nëntor ka paraqitur raportin e fundit për projekt-draftin. Ai e ka mbështetur plotësisht dhe ka treguar që

ka përmirësime të ndjeshme nga drafti fillestar, duke vendosur edhe një sërë komentesh, të cilat janë reflektuar gjatë punës së kryer në Komisionin e Ligjeve. Më lejoni të ndalem në disa prej tyre. Si shembull jepen referencat që lidhen me besimin politik ose pjesëmarrja në unione të caktuara, në nenin 31/1 dhe 33/1, pra kjo referencë është hequr në reflektim të komentit të ekspertit të OSBE-së. Komenti tjetër lidhet me rolin e AMA-s që i referohet mbrojtjes së të drejtave të shprehjes në Shqipëri, si dhe është propozuar ndryshimi i nenit 132 dhe ky propozim i ekspertit përsëri është reflektuar. Pra të gjitha çështjet janë reflektuar nën për nen në komentet që kemi pasur.

Çështjet kryesore lidhen me mbajtjen ose jo të një regjistri të detyrueshëm për mediet elektronike, por edhe kjo çështje është ndryshuar dhe regjistrimi nuk është i detyrueshëm. Pra, është krijuar mundësia për secilën nga mediet elektronike nëse duan për t'u regjistruar dhe nëse regjistrohen ato mund të përfitojnë lehtësime nga taksat dhe lehtësime të tjera. Kjo është një zgjidhje që është dhënë për të ruajtur balancën e nevojës për t'u regjistruar dhe detyrimin që ka mosushtimi ose mosrregjistrimi i medias si parakusht për të ofruar shërbime medietike.

Po ashtu është diskutuar edhe për çështjen e gjobave, sepse janë shumë të larta dhe mund të jetë si një deterrent për ushtimin e shërbimit medietik. Edhe kjo pikë, gjatë punës në Komisionin e Ligjeve, është ndryshuar gjerësisht. Pra gjobat janë bërë në proporcion me shkeljen e kryer, si dhe AMA është detyruar ose do të detyrohet për të krijuar një rregullore të posaçme, që për shkelje të caktuara gjoba të jetë në formë udhëzuesi. Pra gjoba të jetë proporcionale dhe e përshtatur me shkeljen konkrete. Këto dy çështje janë më kryesoret. Unë besoj se janë shteruar më së miri të gjitha shqetësimet që kanë pasur organizatat ndërkombëtare për çështje konkrete.

Ndërsa në lidhje me nismën nëse do të merret apo jo, kjo është një çështje që i takon Kuvendit për të vendosur rregullimin ose jo të kësaj fushe. Mënyra se si rregullohet mund të jetë një çështje që mund të diskutohet gjerësisht në nivel ekspertësh. Në vlerësimin tonë mënyra se si është propozuar për t'u rregulluar është mënyra më e mirë që garanton nga njëra anë mbrojtjen e interesit publik, të shtetasve e qytetarëve dhe nga ana tjetër mbrojtjen e interesit ose të drejtës së lirisë së shprehjes së medieve.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – A është e mundur që përfaqësuesit e këtyre institucione që kanë ndihmuar dhe që ju i keni marrë në konsideratë, të bëjnë një pohim të kësaj që po thoni, në

mënyrë që të mbyllet kjo histori? Pra një prononcim sado i thjeshtë do të ndihmonte shumë në sqarimin e kësaj mjegullnaje që është përhapur në vend.

Niko Peleshi – Po, zoti Valteri.

Halit Valteri – Pra është folur, kundërshtuar, spekuluar dhe çfarë nuk është bërë për ligjin antishpifje, por ne duhet të ndalemi pak në atë që kundërshtojnë shoqatat e medieve, të cilat kanë dalë me variantin zyrtar. Ato pretendojnë që është cenimi i lirisë së shprehjes dhe i parimeve të vetërregullimit të medieve. Çfarë kërkon shoqata e medieve? Kërkon rregullim të tyre nëpërmjet krijimit të institucioneve vetërregulluese, që mund të ngrihen nga komisioni i gazetarëve dhe i ekspertëve profesionistë për lirinë e medieve. Pra AMA dhe AKEP-i janë institucione publike administrative që zgjidhen nga pushteti politik dhe nuk mund të jenë garantë të medies. Këtë kërkojnë ata.

Ky ligj që vjen, por edhe ligjet që do t'i bashkohen, siç është ligji aktual i medieve audiovizive, sa e garanton lirinë e medieve? Sa e garanton kontrollin financiar të këtyre medive, jo vetëm kontrollin për heqjen dhe vënien e fishës? Gjobat që do të marrin portalet do të jenë politike? Pra sa të lirë do të jenë AMA dhe AKEP-i? Këtë merak kanë shoqatat e medieve.

Niko Peleshi – Po, zoti Shtjefni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Unë i mirëkuptoj kolegët që për sensibilitetin që ka krijuar ky projektligj ata vazhdojnë të kenë ende paqartësi, të bëjnë pyetje dhe kërkojnë të marrin përgjigje, por ne kështu po i kthehemi edhe një herë diskutimit në parim të këtij projektligji. Ne duhet të fillojmë diskutimin nen për nen dhe kur të shkojmë te neni përkatës, secili nga ne mund të adresojë pyetjen dhe paqartësitë që kemi në nenin përkatës. Prandaj, zoti kryetar, mendoj të fillojmë me diskutimin nen për nen dhe pyetjet tona mund të kenë vend për t'u elaboruar përsëri.

Niko Peleshi – Këtë kishit edhe ju, zoti Shtjefni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Fjalën e ka kryetari i AMA-s dhe pastaj fillojmë me diskutimin nen për nen.

Gentjan Sala – Autoriteti i Medieve është shprehur kundër me vendim për këtë çështje. Ne e kemi si traditë në institucion që sa herë bëhet propozim për ndryshim ligji, shprehet bordi. Bordi ka vendosur 3 me 2 që ta hedhë poshtë këtë çështje.

Ka një ndarje shumë të thellë edhe në bordin tonë, shumë veta e shikojnë si ndarje profesionale, juristët e shikojnë shumë të thjeshtë këtë çështje, sepse nuk mund t'i hiqet e

drejta e ankimit një personi, ndërsa ata që janë publicistë, gazetarë e shikojnë si cenim të lirisë së shprehjes së medias. Pra, kjo çështje është shumë delikate.

Ne e kemi diskutuar përpara një viti këtë projektligj duke bërë konsultime dhe qëndrimet është i gazetarëve që mendojnë se është antikushtetues, një qëndrim është që nuk do të ketë efektivitet si ligj dhe kjo edhe sot për mendimin tim qëndron, mund t'ju them edhe argumentet kur të dalim te nenet. Për aq kohë sa kemi një reformë drejtësie që është në ecuri e sipër, mos është më mirë që t'i lihet reformës të gjykojë edhe çështjet e shkeljes së fjalës së lirë të gazetarëve me procedurë gjyqësore, sikurse është edhe tani dhe të mos futet në një diskutim administrativ? Shqetësimet e gazetarëve janë edhe teknike, pra nuk janë thjesht në parim. Pra organizatat ndërkombëtare nuk janë kaq solide. Organizatat si: Këshilli i Europës, BE-ja dhe OSBE-ja, pra të tria së bashku në parim kanë thënë që jemi për vetërregullim.

Meqenëse jemi dytësor për këtë komision, OSBE-ja ka luajtur jo me një dhe dy porta, por edhe me tri porta. Nuk u është përgjigjur institucioneve publike direkt, pra qeverisë, nuk u është përgjigjur direkt gazetarëve, por ka thënë: “AMA nuk duhet të kthehet në gjyqësor”. Për mendimin tim, kjo është e padrejtë, sepse për çështjet që ne gjykojmë në vazhdimësi për televizionet dhe mediet e tjera ne jemi gjyqësor. Pra, për OSBE-në unë kam rezervat e mia, por si institucione ndërkombëtare, kur kanë qenë së bashku, kanë thënë vetërregullim.

Gazetarët thonë: “Përse duhet bërë një situatë e tillë, kur situata është kaq e jashtëzakonshme. Ndërkohë që ligji për mediet audiovizive është diskutuar 7 vjet.” Është e vërtetë që ka pasur diskutime, por është ky ligji më i diskutuar Republikën e Shqipërisë, ndërkohë që variantet për këtë ligj kanë ndryshuar katër herë. Është bërë një diskutim mes vetë institucioneve, pastaj i është çuar OSBE-së, është ndryshuar eksperti, ka ardhur përsëri një vendim, pra tjetër thotë eksperti i OSBE-së, tjetër thotë kryetari i OSBE-së dhe tjetër thotë drejtuesi i OSBE-së në Vjenë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. A e kanë të gjithë përpara tabelën me dy variantet, variantin e Këshillit të Ministrave dhe variantin e përmirësuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë duhet të shumëfishohet dhe t'u shpërndahet të gjithëve, sepse nuk ecet dot ndryshe, Elona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë ka diçka.

Gentjan Sala – Dua të sqaroj pak tabelën.

Niko Peleshi – Po, urdhëroni!

Eglantina Gjermeni – Pas ndërhyrjeve të fundit të ekspertëve të OSBE-së, pothuajse shumica e tyre janë reflektuar te tabela, duke dhënë një draft të ripërpunuar me amendamentet, të cilat ne do t'i diskutojmë gjatë shqyrtimit nën për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ky është varianti i ripunuar i grupit të punës, ndërkohë që Komisioni i Ligjeve ka bërë disa ndryshime të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord bëjmë 5 minuta pushim sa të shumëfishohet raporti.

(Pas pushimit)

Këtu kemi tabelën me dy draftet, majtas është drafti i propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe në të djathtë është drafti i ripunuar me amendamentet e propozuara nga grupi i punës, i përbërë nga relatorët e Komisionit të Ligjeve dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke reflektuar edhe opinionet e ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë.

Neni 1. A ka diskutime? Nuk ka. E hedhim në votim.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. A ka diskutime? Nuk ka. E hedhim në votim.

Kush është dakord? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. A ka diskutime? Nuk ka. E hedhim në votim.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4. A ka diskutime? Nuk ka. E hedhim në votim.

Kush është dakord? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5. A ka diskutime? Nuk ka. E hedhim në votim.

Kush është dakord? Kundër? 1 votë. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6. A ka diskutime?

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Në pikën 2 të nenit 6 thuhet: “Ky ligj interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe

Lirive Themelore, sikurse zbatohet në praktikat ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”. Unë dua të di nga përfaqësuesit që janë këtu një interpretim më të gjerë, pra çfarë kemi parasysh në këtë pikë.

Niko Peleshi – Duhet të keni parasysh se draftin që ne po votojmë, i cili është në të djathtë të tabelës, në këtë nen janë shtuar disa fjalë. Në pikën 1 fjala “mund” është zëvendësuar me fjalën “duhet”. Pra në variantin e parë thuhet: “...ligji nuk mund të interpretohet...”, ndërsa varianti që po diskutojmë thuhet: “...nuk duhet të interpretohet...”. Gjithashtu, te pika 2 është shtuar fjala “dhe zbatohet”. Pra “... ky ligj duhet të interpretohet” thotë varianti i parë, ndërsa varianti që po diskutojmë dhe po votojmë është “...ky ligj interpretohet dhe zbatohet...”. Ndërkohë kërkohet, nga relatori një shpjegim më i shtjelluar i këtij nen.

Besmir Beja – Qëllimi fillestar i nenit është që të garantojë zbatimin e ligjit, si dhe mënyra se si do të interpretohet nga organet administrative, AMA në këtë rast apo edhe gjykatat në të ardhmen, duhet të ketë në konsideratë praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky është kuadri kryesor që duhet të garantojë dhe të vendosë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka një praktikë të mirë në raport se si e ka balancuar lirinë e shprehjes dhe nevojën për t’i bërë me dije publikut informacionet që kanë rëndësi dhe, nga ana tjetër, të garantojë jetën private të çdo qytetari. Pra, këto janë konturet brenda të cilave do të veprojnë si organet administrative, ashtu edhe gjykatat shqiptare, duke pasur në konsideratë këtë lloj praktike. Nëpërmjet këtij neni synohet që të hiqet çdo lloj pretendimi që ky ligj duhet përdorur ose mund të përdoret si instrument për të kufizuar lirinë e shprehjes, për aq kohë sa lirinë e shprehjes ne e kemi të garantuar me Kushtetutë, por edhe me garanci që i kemi vendosur me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në zbatim të këtij ligji ne u garantojmë qytetarët, po ashtu edhe shërbimeve medietike këtë lloj interpretimi. Pra, ky është shkaku dhe qëllimi kryesor pse ne e kemi bërë në këtë ligj këtë lloj parashikimi.

Niko Peleshi – Dakord!

Atëherë, e hedhim në votim nenin 6, variantin e punuar.

Kush është dakord? Kundër? 1 Kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7. Titulli i kreut II ndryshohet si më poshtë vijon: “Autoriteti Shqiptar i Medieve” bëhet “Autoriteti i Medieve Shqiptare (AMA)”, që është edhe propozimi i OSBE-së.

Besmir Beja – Nëse e çmoni me interes, për shkak se ne kemi marrë pjesë edhe te Komisioni të Ligjeve, mund t’iu bëjmë me dije ndërhyrjet që ka bërë Komisioni i Ligjeve për secilin nen, pasi ka pasur disa ndërhyrje. Në rast të kundërt, më thoni se si e çmoni ju. Për shembull, në nenin 6, Komisioni i Ligjeve nuk vendosi ta linte fjalën “duhet”, por vendosi të linte fjalën “mund”, siç ishte në versionin fillestar. Megjithatë, kjo është në vlerësimin tuaj, nëse e keni të nevojshme këtë lloj informacioni shtesë apo jo.

Niko Peleshi – Faleminderit, por ne nuk jemi komision përgjegjës. Ashtu si Komisioni i Ligjeve, edhe ne jemi komision për dhënie mendimi. Ai që do t’i agregojë mendimet e të gjithëve është Komisioni i Edukimit dhe Medies, kështu që ne do të vazhdojmë me draftin e përgatitur nga grupi i punës, të cilin e kemi të gjithë para.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8.

Zonja Gjermani ka diçka për të shtuar.

Eglantina Gjermani - Unë kam një merak. Sipas ligjit të barazisë gjinore në çdo institucion të emëruar apo të zgjedhur është vendosur kuota 30% për secilën gjini. Unë mendoj se edhe në bordin e AMA-s kjo gjë duhet bërë, megjithëse ky komision nuk ka në fokus çështjet gjinore. Ndaj, unë e respektoj mendimin e relatorit që do të fokusohemi kryesisht te lidhja që kemi me AKEP-in, por përfitoj nga rasti që të bëj një sugjerim, më pas, ju, si kolegë, keni të drejtë të bini dakord ose jo dhe kjo t’i përcillet komisionit përgjegjës.

Unë mendoj që pika 1 e nenit 8 të ndryshojë, si më poshtë: “AMA përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë, nga të cilët jo më shumë se 70% dhe jo më pak se 30% i përkasin secilës gjini”. Në fakt, kështu duhet të jetë, sepse është detyrim ligjor, përderisa ligji i barazisë gjinore është në fuqi, por në mënyrë eksplicite mendoj se duhet përcaktuar edhe këtu. Unë nuk e kam marrë mendimin tuaj, në kuptimin që nuk jemi konsultuar më parë, por po e bëj tani sugjerimin tim dhe, në qoftë se nuk biem dakord, më pas unë do ta bëj amendim për seancën plenare.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Po, zonja Malodhi.

Irena Malodhi – Kjo duhet të shikohet pak në harmoni me nenin, i cili në mënyrë eksplicite, e sqaron procedurën e emërimit të kryetarit dhe të anëtarëve të AMA-s, pasi është procedurë shumë e rregulluar.

Niko Peleshi – Po, urdhëroni.

Gentjan Sala - Për mua është një kërkesë shumë me vend, duke pasur parasysh edhe praktikën që shumë ankesa kanë lidhje me fëmijët dhe me barazinë gjinore, por do të ishte mirë që të shtohet jo vetëm te bordi AMA-s, këtu mendoj se është më e thjeshtë, pasi është riformatim, por edhe te Këshilli i Ankesave, se aty janë gazetarë me eksperiencë, janë 3 do të bëhen 5. Pra, nga 3 anëtarë, një është femër dhe do të ishte mirë që të bëhet për të dyja bordet. Unë e shikoj shumë me vend këtë kërkesë.

Eglantina Gjermeni – Ajo që ju thatë është shumë e drejtë, por, sigurisht, unë nuk jam juriste dhe nuk e di këtë pjesë. Realisht, edhe fakti që ligji i barazisë gjinore është në fuqi, parimisht të gjitha bordet e kanë detyrim ligjor që të kenë kuotën gjinore dhe të paktën 30% e anëtarëve duhet të jenë nga e njëjta gjini. Ne mund t’ia japim si sugjerim komisionit përgjegjës dhe të gjendet një formulim i saktë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Dakord!

Atëherë, meqenëse kemi një propozim konkret nga zonja Gjermeni, e hedhim fillimisht në votë propozimin, pra ndryshimin e nenit 8, i cili natyrisht do të formulohet nga shërbimi i komisionit. Pra, ideja është që të fusim si kriter edhe barazinë gjinore kur të kompozohen organet vendimmarrëse të AMA-s, që janë Bordi dhe Këshilli i Ankesave, apo jo?

Kush është dakord me këtë propozim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8 me ndryshimin propozuar nga zonja Gjermeni.

Kalojmë te neni 9. A ka diskutime?

Edhe këtu janë bërë ndryshime duke marrë parasysh rekomandimet e OSBE-së.

Kush është dakord nenin 9? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 10, i ndryshuar me rekomandimet e OSBE-së.

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Unë doja të bëja të ditur se nga varianti i Këshillit të Ministrave te varianti i përpunuar kemi disa shtesa nenesh, prandaj neni 11 dhe 12 janë nene të shtuara nga varianti fillestar, kështu që duhet ta kemi parasysh këtë gjë.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Sqarimi është me vend. Pra, ne po diskutojmë për nene, të cilat nuk janë ndryshime nga variantit i parë, por janë shtesa në variantin e ripunuar.

Kush është dakord me nenin 10? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet

Neni 11. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13, i cili ka disa ndryshime dhe, me sa shikoj, është shtuar një togfjalësh në fjalinë e dytë "...shtesat e mëposhtme:" në "...dhe shtesat e mëposhtme". Pra, ky është ndryshimi.

Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14. A ka diskutime për këtë nen?

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Neni 14 është neni i parë i këtij projektligji që fillon të interpretojë detyrimet e reja për AKEP-in. Kështu që unë do të doja të dija nga përfaqësuesi i AKEP-it nëse është dakord me këtë gjë. A keni ndonjë koment për shkronjën "j", që është në draft në lidhje me këto ndryshime?

Bleron Dokle - Nuk kemi komente, pasi ato janë pasqyruar edhe në ligjin nr. 9918 "Për bashkëpunimin me AMA-n".

Niko Peleshi - Kush është dakord me nenin 14? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. A ka diskutime apo komente? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 23. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 24. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28. A ka diskutime apo komente?

Ka diçka zoti Pëllumbi dhe më pas përfaqësuesi i AKEP-it.

Arben Pëllumbi - Neni 28 i këtij projektligji është pikërisht neni që ndoshta ka bërë të mundur që të jemi komision për dhënie mendimi, sepse pikërisht këtu vendosen disa detyra të reja që i ngarkohen AKEP-it, të cilat më pas besoj se do të reflektohen edhe në projektligjin që kemi në vazhdim. Kështu, si në pjesën e parë do të doja që edhe këtu të dëgjoja mendimin e përfaqësuesit të AKEP-it. Nga diskutimi i bërë më parë, ka një lloj konceptimi ndryshe për këtë projektligj, kështu që nëse vërtet ne duhet të japim një mendim më të specializuar, ky është ligji përkatës për të diskutuar.

Jetmir Braha – Faleminderit!

Atëherë, në Komisionin e Ligjeve ne, si përfaqësues të AKEP-it, kemi propozuar që në nenin 28, pika 1, shkronja “a ii” fjala “...nëpërmjet AKEP-it...” të hiqet, sepse flasim për ligjin e AMA-s dhe vendimmarrjet e AMA-s dhe ky është një detyrim që u vendoset portaleve. Ndërkohë, në ligjin “Për komunikimet elektronike” në nenin 2, pika 1, AKEP-i e ka të ndaluar të shqyrtojë përmbajtjet e komunikimeve elektronike. Në thelb, vetë teknikisht “*pop up*”-i është një mesazh që i imponohet portalit. Kështu, nëse ne do të imponojmë një mesazh të tillë, do të thotë që të imponojmë edhe përmbajtjen, ndërkohë që AKEP-i e ka të ndaluar këtë gjë nga ligji nr. 9918. Prandaj, ne kemi propozuar që vetëm fjala “...nëpërmjet AKEP-it...” të hiqet.

Arben Pëllumbi – Pra, të bëhet AMA?

Jetmir Braha – Siç është vendosur për një njoftim të karakterizuar, teknikisht si “*pop up*”. Pra, thjesht të fshihet fjala “...nëpërmjet AKEP-it...”, sepse këtu flasim për portalet.

Niko Peleshi – Çfarë mendimi ka kryetari i AMA-s?

Gentian Sala - Ndoshta tani këtu duhej të kishim edhe ndonjë gazetar, por mua më duket se është tjetër gjë njoftimi dhe tjetër përmbajtja. Njoftimin në përmbajtje e bën AMA, kurse ky është thjesht njoftim. Pra, nuk e vendos AKEP-i, por e vendos AMA, por si dy institucione të një shteti bashkëpunojmë me njëri-tjetrin dhe AKEP-i e ka më të thjeshtë njoftimin dhe nuk më duket se është ndonjë shkelje. Kjo nuk ka të bëjë me mesazhin, sepse në mesazh bëhen ndryshime në përmbajtje.

Irena Malolli – Në lidhje me këtë ka një riformulim që do të vijë nga Komisioni i Ligjeve, gjë për të cilën u dakordësua. Pra, është bërë një bashkim i pikës “i” me pikën “ii”, duke ruajtur detyrimin për vendosjen e riformulimit të korrigjuar, plus mesazhin e dallueshëm me karakteristikën teknike “*pop up*”. Problemi që diskutohet këtu nuk është nëse e ka apo nuk e ka AKEP-i pjesën e gjykimit lidhur me përmbajtjen, por instrumenti me të cilën e kap AKEP-i portalin. AKEP-i vepron ndaj ISP-ve dhe instrumenti ligjor është neni 15, shkronja “e”, për urdhërimin e bllokimit të aksesit apo kufizimin e aksesit, ndërsa pjesa e “*pop up*” –it është diçka që administrohet nga vetë ai që administron portalin.

Arben Pëllumbi – Pse nuk e ka ndryshuar Komisioni i Ligjeve këtë gjë?

Irena Malolli - Do ta sjellim, por është mbi këtë që është në tabelë. Pra, ne ramë dakord që të bëjmë një riformulim.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi ka diçka për të shtuar.

Arben Pëllumbi – Për sa kohë që edhe Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi, ne nuk mund të presim se çfarë ka vendosur ky komision. Agregimin e të gjitha amendimeve tona do ta bëjë Komisioni i Medies, sigurisht, nëse do të marrë parasysh variantin tonë apo do të nxjerrë një variant të ri, ky është detyrim i tyre. Kështu që në këtë moment unë propozoj që ne të mbetemi në variantin që ka dhënë AKEP-i, pra ta heqim fjalën “...nëpërmjet AKEP-it...”, dhe më pas le ta gjykojë Komisioni i Medies nëse duhet të bashkohen pika “i” me pikën “ii” apo jo.

Arben Pëllumbi – Të heqim vetëm fjalën “...nëpërmjet AKEP-it...”, pra të njëjtën gjë që propozoi edhe përfaqësuesi i AKEP-it dhe ky të jetë varianti ynë.

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Atëherë, kemi një propozim për të cilin edhe unë jam dakord.

E hedhim në votë propozimin e zotit Pëllumbi. Kush është dakord që të miratohet ky nen, duke hequr togfjalëshin “...nëpërmjet AKEP-it...”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 28 me ndryshimin që sapo cituam, pra hiqet togfjalëshi “...nëpërmjet AKEP-it...”.

Kalojmë te neni 29, që lidhet me masat e gjobave. A ka diskutime?

Po, urdhëroni zoti Gent.

Gentian Sala - Komisioni i Ligjeve mori parasysh shumë propozime, por propozimin e AMA-s nuk e mori parasysh, ndaj unë po e shpreh edhe këtu, që gjobat të lihen siç ishin, pra nga 40 mijë deri në 400 mijë lekë të rinj. Pra, ne nuk shikojmë asnjë arsye që në këtë moment të rrisim gjobat e portaleve kur dihet se fuqinë financiare e kanë shumë më të vogël, pavarësisht se është vënë proporcionalitet.

Niko Peleshi – Pra, ju thoni të lihen nga 40 mijë deri në 400 mijë?

Gentian Sala – Po, siç ka qenë.

Niko Peleshi - Tani është bërë 40 mijë deri në 800 mijë?

Gentian Sala - Është bërë 100 mijë deri në 1 milion lekë të rinj.

Unë mendoj që të mbetet siç është në ligjin aktual, pra masa e gjobës të mos ndryshojë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ne duhet të kemi parasysh se portali e ka shpejtësinë e lajmit të jashtëzakonshëm.

Niko Peleshi – Po, këtu bëhet diferencimi i portaleve me mediet e tjera audiovizive?

(Diskutime pa mikrofon)

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Unë besoj se ne vazhdojmë të mos jemi në fushën e kompetencës sonë për të gjykuar nëse ky nivel gjobe është i duhuri apo jo, sepse ne nuk e kemi panoramën e plotë të ligjit për mediet audiovizive, pra të atij aktualisht dhe të ndryshimeve që po kalojmë sot, kështu që le t’ia lemë në kompetencë këtë gjë komisionit përgjegjës, që është Komisioni i Medies. Me çfarë dëgjova, edhe Komisioni i Ligjeve ka mbajtur të njëjtin qëndrim, ndaj unë propozoj që ta miratojmë nenin 29 kështu siç e kemi para.

Eglantina Gjermani – Më falni, kam një pyetje për përfaqësuesen e Ministrisë së Drejtësisë?

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Pse kjo gjoba është ndryshe vetëm për komunikimet elektronike?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë ndryshuar të gjitha? Në rregull, sepse mendova se ishte ndryshuar vetëm kjo.

Niko Peleshi - A ka diskutime të tjera?

(Diskutime pa mikrofon)

Ideja është se kjo që tha zoti Pëllumbi qëndron. Ne nuk mund të propozojmë ndryshime në shifra, sepse që të ndryshosh shifrat duhet ta kesh parasysh të gjithë panoramën, madje jo vetëm gjokat e fushës, por të gjitha gjokat e tjera, pasi gjokat vendosen në proporcion. Tani, ne nuk e kemi këtë studim, nuk e kemi këtë analizë, por qëndron si vërejtje. Domethënë, ne mund ta sugjerojmë që të merret në konsideratë mendimi i specializuar i AMA-s lidhur me ndryshimin e masës së gjobave, në qoftë se do të bini dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Po ia kaloj edhe një herë fjalën zotit Sala.

Gentian Sala - Unë po ju jap një argument: “Top Channel” e ka *turn over*-in, pra xhiron 14 milionë euro, “Klani” e ka 13 milionë euro, “RTSH”-ja e ka 22 milionë euro dhe të gjitha marrin të njëjtën masë gjobe, kurse portali ka 5 apo 10 veta dhe e ka masën e gjobës 10 milionë lekë. Normalisht, për portalin kjo masë gjobe do të thotë mbyllje e tij.

Niko Peleshi – Po, relatori.

Arben Pëllumbi – Ky është neni i parafundit që ne po diskutojmë sot dhe kemi pasur këtë frymë në diskutimin nen për nen: moskompetenca jonë për të ndërhyrë në ato nene ose mosthëllimi i diskutimit për të ndërhyrë në ato nene, për të cilat ne nuk e kemi të gjithë panoramën e qartë. Pavarësisht faktit që ne, si Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në parim jemi për mosrritjen e gjobave dhe për mbrojtjen e biznesit, këtu kemi një konflikt me atë që vendosëm për filozofinë tonë. Kështu që nëse ana juridike e komisionit e shikon të mundur, ne duhet të dalim me një sugjerim, por, nëse do të vazhdojmë të diskutojmë për këtë nen, atëherë bie e gjithë filozofia jonë me të cilën e diskutuam të gjithë projektligjin nen për nen.

Niko Peleshi - Ne mund ta miratojmë si nen dhe në raport do të bëjmë një sugjerim.

Atëherë, e hedhim në votim nenin 29, siç është i formuluar, por me një asterisk, pra me një shënim në raport ku të përmendet sugjerimi i bërë nga përfaqësuesi i AMA-s dhe argumenti i tij, të cilit i bashkohemi edhe ne në interesin që kemi për të mos i rënduar apo për t’i lehtësuar sa më shumë të jetë e mundur të gjitha subjektet, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike. Pra, në këtë rast ne i shikojmë portalet si subjekte ekonomike, pasi e tillë është edhe fusha e komisionit tonë.

Kush është dakord që ta miratojmë nenin 29 siç është, por me këtë shënim në raport? Kundër? I kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni i fundit, neni 30. Kush është dakord? Kundër? 1 kundër. Abstenim?
Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit? Kush është dakord? Kundër? 1 kundër.
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Falënderoj përfaqësuesit e AKEP-IT, të AMA-s dhe të të dyja ministrive për të gjitha
sqarimet!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 16.12.2019, ora 14:30

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Lefter Koka, Zef Shtjefni, Halit Valteri, Klajdi Qama dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Tatiana Nurçe, Ilir Beqaj dhe Kujtim Gjuzi.

Të ftuar:

Besmir Beja – Drejtor i Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Irena Malolli – Drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Gentjan Sala – kryetar i AMA-s

Jetmir Braha – Drejtor i Autorizimeve në AKEP

Bleron Dokle – përfaqësues nga AKEP

Niko Peleshi - Unë do t'u lutesha përfaqësuesve të AKEP-it që të qëndrojnë, pasi do të vazhdojmë me miratimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Relatore e këtij projektligji është zonja Gjermani.

Atëherë, po i jap fjalën zonjës Gjermani dhe më pas kalojmë te diskutimet, pyetjet dhe te miratimi nen për nen dhe në tërësi.

Eglantina Gjermani - Faleminderit, kryetar!

Në fakt, ne e kemi hapur diskutimin dhe kemi pritur edhe amendimet e komisioneve për dhënie mendimi. Deri tani kemi marrë variantin dhe sugjerimet nga Komisioni i Ligjeve, të cilat, pak a shumë, i trajtuam edhe te projektligji që sapo miratuam. Unë mendoj se duhet të kalojmë në diskutimin nen për nen të këtij projektligji, duke qenë se ky projektligj, në fakt, reflekton më shumë legjislacionin në fuqi për komunikimet elektronike dhe të gjitha ndryshimet që janë propozuar rregullojnë shërbimet e publikimeve elektronike. Unë sugjeroj që ta kalojmë nen për nen, duke përfshirë edhe komentet e ardhura nga Komisioni i Ligjeve.

Niko Peleshi - Meqenëse komisioni ynë është komision përgjegjës për projektligjin e komunikimeve elektronike, duhet të presim raportet e dy komisioneve të tjera për dhënie mendimi. Komisioni i Ligjeve e ka mbaruar diskutimin dhe miratimin dhe Komisioni i Medies e ka shtyrë sot në orën 17:00.

Unë i kam kërkuar nënkryetares të Komisioni të Medies që këtë projektligj ta diskutojnë si pikë të parë të rendit të ditës, kështu që mbledhjen po e caktoj sot në orën 18:00. Pra, sot në orën 18:00 do t'i kemi administruar të dyja raportet e komisioneve të tjera dhe do të kalojmë në diskutimin dhe miratimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Pra, shihemi në orën 18:00.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA